



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:106003  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05738807

**Ac.nr.3417/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.M nga „, Rr. „,“, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H nga „, kundër të paditurës IMK-Industria Metalike e Kosovës, me seli në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson A.P, me objekt të padisë kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1372/20, të datës 09.03.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datën **27.05.2024**, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurës IMK-Industria Metalike e Kosovës, me seli në „, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1372/20, i datës 09.03.2021 dhe çështja gjykohet si në vijim:

- **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit H.M nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura e paditura IMK-Industria Metalike e Kosovës seli në „, që t’ia paguaj paditësit në emër të tri pagave jubilarë shumë prej 759.00€, me kamat prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njejtit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1372/20, të datës 09.03.2021, në pikën I (një) të dispozitivit, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit H.M nga „, dhe e ka detyruar të paditurën IMK-Industria Metalike e Kosovës, me seli në „, që t’ia

paguaj paditësit në emër të tri pagave jubilarë shumë prej 759.00 Euro, me kamat prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën, që t'ia paguaj paditësit H.M shumë prej 135 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës dhe aktgjykimin e atakuar prish e lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*- Ankesa e të paditurës është e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datën 17.04.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që e paditura t'ia paguajë pagesën e pagave përcjellëse dhe tri paga për shpërblimin jubilar, më gjerësisht si në padi.

Fillimi, gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.353/18, të datës 17.07.2018, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi. Kundër aktgjykimit C.nr.353/18, të datës 17.07.2018, kishte ushtruar ankesë e paditura, ndërsa Gjykata e Apelit me aktgjykimin Ac.nr.4117/2018, të datës 20.05.2019 e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës, me të cilën aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me vendosjen për kompensimin e pagave përcjellëse në pension e kishte vërtetuar, ndërsa vendosjen lidhur me kompensimin e pagave jubilarë e kishte kthyer në rigjykim.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin tani të atakuar C.nr.1372/20, të datës 09.03.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata vlerëson se paditësi ka të drejtë në realizimin e tri pagave jubilarë, për arsye se i njëjti ka përvojë të punës mbi 40 vite, kjo është paraparë në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 01.01.2015. Vërtetimin e faktit vendimtar sa i përket përvojës së punës,

Gjykata e vërtetoi përmes librezës së punës me numër ,, në të cilën shënohet se paditësi në vitin 1972 ka 1 muaj e 27 ditë; nga viti 1972 deri në vitin 1990 ka 17 vite, 5 muaj e 6 ditë; nga viti 1990 deri në vitin 2007 ka 17 vite, 9 muaj dhe 1 ditë, ndërsa tek e paditura nga koha e privatizimit e deri në kohën e daljes në pension me datë 07.07.2015 ka përvojë të punës 6 vite e 11 muaj, se kjo përvojë e fundit e paditësit nuk ishte kontestuese as nga e paditura. Nga këto fakte me rëndësi vërtetohet përvoja e punës së paditësit dhe atë 42 vite, 3 muaj e 3 ditë. Paditësi sa i përket pagave jubilarë për 30 vite të përvojës së punës i takojnë tri paga jubilarë në vlerën e tri pagave të fundit të marrura tek e paditura si punëdhënëse e fundit e tij, bazuar në nenin 52 të MPKK, ndërsa paga mujore e paditësit është vërtetuar se është 253.00 Euro, përmes kontratës së punës. Lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, sipas së cilave përcaktohet se *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragrafi”*. Këto dispozita përcaktojnë të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në këtë dispozitë për shkak se kërkesa është parashkruar dhe prapësimin e parashkrimit e ka paraqitur e paditura në seancën përgatitore të datës 19.06.2018, seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.07.2018, duke ritheksuar se qëndron pranë kundërshtimeve të tilla edhe gjatë shqyrtimit kryesor i zhvilluar në procedurën e rigjyimit të datës 09.03.2019 duke u thirrur në prapësimin e parashkrimit.

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar pretendimin e të paditurës për parashkrim, gjen se në këtë çështje juridike kontestuese kërkesa është parashkruar për çka vendosi që ta refuzoj si të

pabazuar kërkesëpadinë. Në këtë rast Gjykata e Apelit i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se: *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*

Në rastin konkret paditësi ka arritur përvojën e punës në kohën kur nuk ka qenë në fuqi ndonjë Kontratë Kolektive. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ku është paraparë e drejta për paga jubilarë ka hyrë në fuqi më 01.01.2015, që do të thotë se paditësi i është krijuar kjo e drejtë nga data 01.01.2015, ndërsa padinë për kompensimin e pagave jubilarë në gjykatë e ka ushtruar me datën 17.04.2018, që rezulton se nga koha kur paditësi ka arritur të drejtën për të kërkuar kompensimin për paga jubilarë dhe kur i është krijuar kjo e drejtë e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë, kanë kaluar mbi tri vite.

Në kuptim të të cekurave kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës kjo gjykatë e ka bazuar në dispozitën e nenit 450, të LPK-së.

Andaj, nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 195 paragrafi 1 pika e), e lidhur me nenin 201 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3417/21, datë 27.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**